

KËRKESË

Nr. 4860/3, datë 2.10.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga Transballkanike” Vlorë. Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe për llogaritjen së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit, “truall”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 1 206 820 (një milion e dyqind e gjashtë mijë e tetëqind e njëzet) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**

Lista per supponimenti passati (1985/1986) in Danese

Решка Влорѣ

Nr.	PRONARI			Zona Kadast.	Nr. i pasurisë	Lloji Paturisë	Sip. Totale (m2)	Sipërfaqe që Shpronësohet (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (në lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Krenar	Selam	Karafili	8604	33/128	Truall	975	145.4	8300	1,206,820	Konfirmim ZVRPP Hipotekohet favor Raiffeisen Bank.
	SHUMA									1,206,820	